



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 603 Akti

Nr. 321 Vendimi

Tiranë, më 10.12.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Brunilda Bekteshi	Anëtare
Genta Tafa (Bungo)	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, më 9.12.2020, ora 12:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Qemal Zaimi**, aktualisht nëpunës përgjegjës në njësinë e vlerësimit etik e profesional në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; **Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; **Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; **Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT, pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të

paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Qemal P. Zaimi, aktualisht me funksionin e nëpunësit përgjegjës në njësinë e vlerësimit etik e profesional në Këshillin e Lartë Gjyqësor, është subjekt që i nënshtrohet rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Për periudhën 1 tetor 2001 - 31 gusht 2007, subjekti ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Librazhd dhe është larguar për shkak të suprimimit të asaj gjykate. Në periudhën 1.9.2007 - 16.12.2007 ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe është larguar për shkak emërimi në detyrën e inspektorit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Në periudhën 17.12.2007 deri në datën e dorëzimit të formularit të vetëvlerësimit (datë 26.1.2017), ka ushtruar detyrën e inspektorit pranë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka hedhur shortin në datën 16.7.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Qemal Zaimi, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët znj. Genta Tafa (Bungo), z. Olsi Komici dhe znj. Alma Faskaj. Relator i çështjes, u zgjodh me short, komisionerja znj. Genta Tafa (Bungo).

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 24.7.2020, u caktua me mirëkuptim kryesues z. Olsi Komici, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Qemal Zaimi.

5. Me vendimin nr. 61, datë 5.10.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit u vendos rishpërndarja e çështjeve të shortuara në datën 16.7.2018 me anëtare trupi gjykues znj. Alma Faskaj, për shkak të mungesës së komisioneres për një afat të pacaktuar, për arsye shëndetësore. Me shortin e hedhur po atë mbledhje, anëtar zëvendësues për këtë subjekt u zgjodh znj. Brunilda Bekteshi, e cila deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me subjektin.

6. Referuar pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Qemal Zaimi, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

7. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

8. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

9. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

10. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

11. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Qemal Zaimi. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;

b) ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar për huamarrjen në shumën 4.700.000 lekë;

c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;

d) nuk ka kryer deklarim të rremë;

e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

12. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin² e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Qemal Zaimi.

13. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

14. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: atë të vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 11.10.2018.

² Raporti me nr. *** prot., datë 26.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. *** , datë 1.12.2020.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 14.10.2020.

15. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 2.12.2020 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për tri kritere për subjektin e rivlerësimit, z. Qemal Zaimi; kalimin e barrës së provës, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016, si dhe njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes dhe rezultatet e hetimit në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

16. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 3.12.2020, dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 7.12.2020.

17. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore⁴.

II. SEANCA DËGJIMORE

18. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 7.12.2020.

19. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më 9.12.2020, ora 12:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

20. Subjekti i rivlerësimit, z. Qemal Zaimi, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Qemal Zaimi, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

21. Z. Qemal Zaimi ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

21.1 Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

22. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet

⁴ Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 7.12.2020.

funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

23. Referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017⁵ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

24. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit, apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore.

VLERËSIMI I PASURISË

25. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 24.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

26. Tokë bujqësore⁶ e ndodhur në fshatin Ermënj, rrethi Gramsh, zona kadastrale nr. ***, sipërfaqe 19.650 m²; zotëron 1/7 pjesë.

⁵ “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlersimit të subjekteve të rivlersimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombtar”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlersimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) Akti i marrjes së rokës në pronësi, datë 30.10.1992; (ii) Certifikatë për vërtetim pronësie e ZVRPP-së Gramsh, lëshuar në datën 25.5.2007, për pasurinë “arë” ndodhur në z.k.***, nr. pasurie ***; (iii) Certifikatë për vërtetim pronësie e ZVRPP-së Gramsh, lëshuar në datën 25.5.2007, për pasurinë “arë” ndodhur në z.k.***, nr.pasurie ***; (iv) Certifikatë për vërtetim pronësie e ZVRPP-së Gramsh, lëshuar në datën 25.5.2007, për pasurinë “arë” ndodhur në z.k.***, nr.pasurie ***; (v) Certifikatë për vërtetim pronësie e ZVRPP-së Gramsh, lëshuar në datën 25.5.2007, për pasurinë “arë” ndodhur në z.k.***, nr.pasurie ***; (vi) Certifikatë për vërtetim pronësie e ZVRPP-së Gramsh, lëshuar datë 25.5.2007, për pasurinë “Arë” ndodhur në ZK.***, nr.pasurie ***; (vii) Çertifikatë për vërtetim pronësie e ZVRPP Gramsh, lëshuar datë 25.5.2007, për pasurinë “Truall” ndodhur në ZK.***, nr.pasurie ***.

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, si pjesëtar familjes bujqësore.

🚩 Hetimi dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

26.1 Në datën 30.10.1992, me Aktin e marrjes së tokës në pronësi nr. ***, familja e z. P. K. Z. (babai i subjektit), ka përfituar 19.930 m² tokë në fshatin Ermënj, Gramsh, nga të cilat 19 630 m² tokë arë dhe 300 m² tokë truall.

Bazuar në shkresën e ZVRPP-së Gramsh konfirmohet se në pronësi të z. P. Z. janë pasuritë e mëposhtme:

- Pasuria “arë” ndodhur në z.k. ***, nr. pasurie ***, me sipërfaqe 6850 m²;
- Pasuria “arë” ndodhur në z.k. ***, nr. pasurie ***, me sipërfaqe 950 m²;
- Pasuria “arë” ndodhur në z.k. ***, nr. pasurie ***, me sipërfaqe 3700 m²;
- Pasuria “arë” ndodhur në z.k. ***, nr. pasurie ***, me sipërfaqe 5800 m²;
- Pasuria “arë” ndodhur në z.k. ***, nr. pasurie ***, me sipërfaqe 2050 m²;
- Pasuria “truall” ndodhur në z.k. ***, me nr. pasurie ***, me sipërfaqe 300 m²;
- Shtëpi banimi në fshatin Ermënj, Gramsh, ndërtuar mbi tokën bujqësore.

26.2 Nga verifikimi i deklaratave periodike dhe deklaratës “Vetting” nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar se ka përfituar të ardhura nga shfrytëzimi i kësaj toke bujqësore, ndërkohë, në përgjigje të pyetësorit të parë, ai ka sqaruar se shpenzimet e jetesës në periudhën tetor 2001-31.12.2005 ai dhe familja e tij i kanë përballuar me pagën e tij, të marrë si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Librazhd, me pagën e marrë nga vëllai i tij si punonjës në Policinë e Burgjeve në IEVP Peqin, si dhe me të ardhurat në formën e prodhimeve bujqësore të realizuara nga toka bujqësore... Prindërit e tij gjatë periudhës tetor 2001 - 31.12.2005, kur ata kanë jetuar së bashku me të në qytetin e Elbasanit, nuk kanë qënë në marrëdhënie pune në këtë qytet dhe as nuk kishin dalë në pension në atë kohë. Si rezultat, ata nuk i shképutën lidhjet me tokën bujqësore në pronësi të tyre dhe në periudha sezonale shkonin e punonin tokën dhe siguronin të ardhura në formën e prodhimeve bujqësore. Këto prodhime ishin në sasi relativisht të vogël, nuk janë përdorur për shitje në treg, por janë përdorur vetëm për konsumin e familjes.

26.3 Subjekti e ka deklaruar këtë tokë, së bashku me një shtëpi banimi të ndërtuar nga prindërit e tij në vitin 1989 në fshatin Ermënj, Gramsh, që në DVP/2003. Në përgjigje të pyetësorit të parë në lidhje me këtë banesë, subjekti ka sqaruar se kur është plotësuar DVP/2003, ai jetonte bashkë me prindërit, motrën dhe vëllezërit e tij në të njëjtin trung familjar. Në këto kushte ata konsideroheshin si persona të lidhur, prandaj ka deklaruar pasurinë që figuronte në emër të familjes së tij. Trualli i banesës është përfituar me ligjin nr.7501, datë 19.7.1991 dhe është pjesë e tokës bujqësore të deklaruar nga ana e tij në deklaratën “Vetting”.

Deklarimet e subjektit konfirmohen dhe nga ana e ZVRPP-së Gramsh, e cila ka informuar se z. Petrit Zaimi ka një shtëpi banimi në fshatin Ermënj, Gramsh, ndërtuar mbi tokën bujqësore.

26.4 Në përfundim të hetimit, Komisioni konstaton se subjekti ka qënë i saktë në deklarimin e kësaj pasurie. Ai nuk ka asnjë kontribut në ndërtimin e shtëpisë, si dhe nuk ka deklaruar

asnjëherë të ardhura nga shfrytëzimi i tokës bujqësore. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se nuk lindin dyshime apo paqartësi për këtë pasuri.

27. Autoveturë⁷ e llojit “Peugot”, model 206, viti i prodhimit 2009, me targa *. Vlera.172.830 lekë; zotëron 50%.**

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: të ardhurat e kursyera nga paga e subjektit dhe bashkëshortes.

Hetimi dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

27.1 Subjekti i rivlerësimit, me kontratën nr. ***, datë 28.6.2010⁸, ka blerë automjetin “Peugeot” në vlerën 8.575⁹ euro. Subjekti ka depozituar faturë tatimore pa numër dhe datë në vlerën 8575 euro (1,172,830) lekë.

27.2 Pranë DPSHTRR-së¹⁰ gjendet fatura e plotësuar, e cila mban datën 26.6.2010, me nr.***, pra dy ditë para lidhjes së kontratës. Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjekti¹¹ ka sqaruar se data e saktë e blerjes së automjetit prej tij është data 26.6.2010, pasi kjo është data kur ai ka kryer pagesën, çmimin e blerjes. Pagesa është kryer *cash*. Subjekti ka paraqitur një deklaratë të datës 28.9.2020 të shoqërisë “****” sh.p.k., e cila deklaron se data e saktë e shitjes së automjetit është data 26.6.2010, ndërsa te kontrata e shitjes është bërë një lapsus në datën e përpilimit të kontratës, pasi duhet të ishte data 26.6.2010.

27.3 Komisioni ka kryer analizën financiare si më poshtë për blerjen e këtij automjeti:

	26.6.2010
PASURI	1 071 232
Autoveturë “Peugeot” TR ***	1 172 830
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>	<i>-101 598</i>
Likuiditete gjendje	4 799 719
TË ARDHURA dokumentuar	1 189 026
Të ardhura nga paga e subjektit	735 088
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	453 938
SHPENZIME	354 131
Shpenzime jetese	197 631
Shpenzime qiraje ¹²	120 000
Shpenzime udhëtimi bashkëshortja (<i>Pyetëtori standard</i>)	24 000
Shpenzime mobilimi	12 500
Mundësia për kursime	-236 337

Të ardhurat dhe shpenzimet janë përlllogaritur si pjesë takuese e periudhës 1 janar deri 26.6.2010. Nga analiza financiare duket se subjekti nuk ka patur të ardhura të mjaftueshme në

⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë nr. ***, datë 28.6.2010; (ii) faturë tatimore shitje vulosur nga “****” sh.p.k Tirana; (iii) certifikatë e pronësisë së mjetit rrugor me targa TR ***.

⁸ Deklaruar në DVP/2010.

⁹ Bazuar në deklaratën doganore import 4 rezulton se vlera e automjetit ka qenë 6.132 euro (843,947.16 lekë) dhe janë paguar detyrime tatimore në shumën 177,185 lekë.

¹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 28.7.2020 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

¹¹ Shiko përgjigjet e pyetëtorit të parë, datë 25.9.2020.

¹² Subjekti në përgjigjet e pyetëtorit standard ka deklaruar se ka jetuar me qira nga viti tetori i vitit 2000. Fillimisht ka jetuar me qira së bashku me prindërit, vëllezrit dhe motrën në qytetin e Elbasanit nga viti 2001-2005. Për periudhën 1.1.2006 - 31.12.2007 ka jetuar me qira me bashkëshorten në qytetin e Elbasanit. Më pas nga viti 2007-2013 ka jetuar me qira në qytetin e Tiranës derisa kanë blerë apartamentin.

shumën 236,337 lekë për të paguar blerjen e automjetit. Për këtë rezultat të hetimit, subjektit iu kalua barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016.

27.4 Në parashtrimet e tij, subjekti ka prapësuar se në deklarin e tij u është referuar të ardhurave familjare të tij në fund të vitit kalendarik, kur ka bërë edhe deklarin dhe jo momentit kur ka bërë blerjen e makinës. Ndërkohë, parashtron ai, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, pothuajse dhjetë vjet, nuk kujton saktësisht këtë diferencë të konstatuar nga Komisioni, por është i sigurt që si burim kanë shërbyer vetëm të ardhurat nga paga e tij dhe bashkëshortes.

27.5 Në përfundim të seancës dëgjimore, pasi shqyrtoi provat dhe shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka arritur të provojë mungesën e të ardhurave në shumën - 236 337 lekë. Pavarësisht se në fund të çdo viti subjekti del me rezultat pozitiv në raportin midis të ardhurave dhe shpenzimeve, në momentin e blerjes së kësaj pasurie ai gjendet në kushtet e pamundësisë financiare.

28. Apartament banimi¹³ me nr. pasurie ***, z.k. ***, me sipërfaqe 98.3 m², e ndodhur në sheshin “***”, rruga “***” pall.***, shkalla ***, kati ***, apartamenti ***, Tiranë. I blerë me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., *** kol., datë 16.12.2013; vlera është 12.460.000 lekë; zotëron 50%.

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: Me të ardhurat e kursyera nga paga e subjektit të deklarin dhe bashkëshortes së tij në vitet e punës në shumën 7.500.000 lekë, të ardhurat nga interesi i bonove të thesarit në shumën 300.000 lekë, si dhe kontratat e kredisë bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.2.2014 e marrë në bankën “Societe Generale Albania” në shumën 4.700.000 lekë.

Konstatimi i ILDKPKI-së: *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar të shtetasit F. H., i cili i ka dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumën 4.700.000 lekë.*

Hetimi dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

28.1 Subjekti dhe bashkëshortja e tij, me kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme nr.*** Kol., datë 16.12.2013, ka blerë apartament me sipërfaqe 98.3 m² ndodhur në Tiranë, me nr.pasurie ***, z.k. ***. Çmimi i shitjes është 12.460.000 lekë ose e konvertuar 89.000 euro.

Bazuar në nenin 2 të kësaj kontrate pagesa do të bëhej si më poshtë:

- Shuma prej 10,560,000 lekë (e konvertuar 75.430 euro) do të likuidohej brenda datës 20.12.2013.
- Deri në datën 30.12.2013 do të likuidohej shuma 1,000,000 lekë e konvertuar në 7.143 euro.

¹³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë shitblerjeje pasuri e paluajtshme “apartament banimi” nr. *** rep, *** kol, datë 16.12.2013; (ii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 27.1.2014; (iii) deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, datë 15.1.2014, (iv) “Tirana Bank”, nxjerrje llogarie në euro në emër të Qemal Zaimi; (v) deklaratë noteriale, nr. *** rep, nr. *** kol, datë 6.1.2014; (vi) 2 ekstrakte historike të personit fizik F. H. së bashku me certifikatat e regjistrimit për secilin NIPT; (vii) kontratë kredisë bankare afatgjatë për shtëpi, nr. *** rep, nr. *** kol, datë 4.2.2014; (viii) kontratë hipotekimi nr. *** rep, nr. *** kol, datë 24.2.2014.

- Deri në datën 15.1.2014 do të likuidohej shuma prej 900.000 lekë e konvertuar 6.427 euro.

Subjekti ka depozituar deklaratë noteriale nr. *** datë 15.1.2014 të palës shitëse, e cila deklaron se blerësi (subjekti dhe bashkëshortja e tij) ka shlyer të gjitha detyrimet për shitblerjen e apartamentit.

28.2 Komisioni ka administruar gjatë hetimit shkresën nr. *** prot., datë 14.09.2020 të ILDKPKI-së, e cila ka vënë në dispozicion dokumentacionin e depozituar nga subjekti gjatë deklarimeve të tij periodike. Pjesë e këtij dokumentacion janë dhe pagesat e kryera për këtë apartament nga subjekti në llogarinë e palës shitëse në “Intesa San Paolo Bank” si më poshtë:

- Në datën 19.12.2013 subjekti ka depozituar shumën 42.000 euro;
- Në datën 20.12.2013 subjekti ka depozituar shumën 33.500 euro;
- Në datën 31.12.2013 subjekti ka depozituar shumën 7.000 euro;
- Në datën 14.01.2014 subjekti ka depozituar shumën 6.500 euro.

28.3 Subjekti si burim për blerjen e këtij apartamenti në DVP/2013 ka deklaruar:

- Të ardhurat në lekë të investuara në vitet paraardhëse në bono në shumën 6,900,000 lekë;
- Të ardhurat e kursyera nga paga gjatë vitit 2013 në shumën 900,000 lekë;
- Hua në shumën 4,700,000 lekë.

28.4 Në lidhje me burimin e deklaruar nga subjekti për të ardhurat e investuara në bono thesari dhe kursime nga paga, nga hetimi rezulton se:

28.4.1 Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të subjektit në bankat “BKT”, “Raiffeisen” dhe “Credins Bank” rezulton se janë tërhequr në total shuma **6,892,000 lekë** për vitin 2013 dhe **900,000 lekë** për vitin 2014, të cilat kanë shërbyer për kryerjen e pagesave të apartamentit.

28.4.2 Nga të dhënat e Bankës së Shqipërisë rezulton se:

A. Subjekti ka blerë bono thesari si më poshtë:

Data e zhvillimit të ankandit	Data e emetimit të bonove të thesarit	Afati	Vlera nominale	Çmimi i blerjes
20.11.2007	22.11.2007	1-vjeçar	2,100,000	1,943,965
20.05.2008	22.05.2008	6-mujor	900,000	867,652
02.12.2008	04.12.2008	1 vjeçar	3,700,000	3,412,088
02.12.2009	03.12.2009	1-vjeçar	3,700,000	3,388,329
15.12.2009	17.12.2009	1-vjeçar	300,000	274,947
30.11.2010	02.12.2010	1-vjeçar	3,700,000	3,448,702
14.12.2010	16.12.2010	1-vjeçar	510,000	476,479
25.11.2011	01.12.2011	1-vjeçar	3,700,000	3,453,380
13.12.2011	15.12.2011	1-vjeçar	510,000	476,938
27.12.2011	29.12.2011	1-vjeçar	1,000,000	937,106
27.11.2012	30.11.2012	1-vjeçar	3,700,000	3,480,187
11.12.2012	13.12.2012	1-vjeçar	510,000	479,484
24.12.2012	27.12.2012	1-vjeçar	1,000,000	940,437

08.01.2013	10.01.2013	1-vjeçar	900,000	844,414
------------	------------	----------	---------	---------

**Interesat e bonove të thesarit, parapaguhën*

Shumat e bonove të thesarit janë disbursuar në llogarinë e subjektit pranë “BKT”-së si më poshtë:

- i. Në datën 9.12.2013 shuma 3,700,000 lekë;
- ii. Në datën 12.12.2013 shuma 510,000 lekë;
- iii. Në datën 19.12.2013 është tërhequr cash shuma 4,200,000 lekë;
- iv. Në datën 26.12.2013 shuma 1,000,000 lekë, e cila është tërhequr në datën 30.12.2013;
- v. Në datën 9.1.2014 shuma 900,000 lekë, e cila është tërhequr në datën 14.01.2014

B. Bashkëshortja e subjektit ka blerë bono thesari si më poshtë:

Data e zhvillimit të ankandit	Data e emetimit të bonove të thesarit	Afati	Vlera nominale	Çmimi blerjes
29.09.2009	1.10.2009	1-vjeçar	800,000	731,409
28.09.2010	30.09.2010	1-vjeçar	800,000	742,699
27.09.2011	29.09.2011	1 vjeçar	800,000	743,165
09.10.2012	11.10.2012	1-vjeçar	800,000	749,322
08.10.2013	10.10.2013	1-vjeçar	800,000	770,443

Subjekti ka depozituar së bashku me pyetësorin standard raport nr. 009, nga ku rezulton se bashkëshortja e tij ka patur bono në vlerë nominale 500,000 lekë dhe çmim blerjeje 458,237 lekë, emetuar në datë 29.09.2005 dhe maturim në datën 28.9.2006. Nga analiza financiare konstatohet se ajo ka patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtyre bonove.

28.4.3 Analiza mbi mundësinë e subjektit për të investuar në bono thesari nga viti 2006 deri në 2012.

	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
PASURI	893 017	1 617 947	1 279 609	1 110 493	1 310 731	990 433	801 116
Autoveturë “Peugeot” TR ***					1 172 830		
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>	<i>893 017</i>	<i>1 617 947</i>	<i>1 279 609</i>	<i>1 110 493</i>	<i>137 901</i>	<i>990 433</i>	<i>801 116</i>
Likuiditete gjendje	893 267	2 511 215	3 790 823	4 901 317	5 039 217	6 029 651	6 830 766
TË ARDHURA dokumentuar	2 221 059	2 138 614	2 361 039	2 546 990	2 440 092	2 392 725	2 681 780
Të ardhura nga paga e subjektit	886 832	1 174 691	1 297 325	1 373 612	1 298 518	1 195 240	1 367 721
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	834 227	803 562	777 480	811 594	836 666	842 015	993 546
Interesa nga bankat/bono thesari	0	160 361	286 234	361 784	304 908	355 470	320 513
Bashkëshortja depozitë para martese	500 000						
SHPENZIME	487 817	524 235	1 050 480	722 860	677 860	716 860	830 266
Shpenzime jetese	219 114	318 780	777 480	409 860	409 860	409 860	418 644

Shpenzime udhëtimi TIMS	123 703	60 455	0	0	0	0	95 010
Shpenzime qiraje	120 000	120 000	240 000	240 000	195 000	240 000	240 000
Shpenzime mobilimi	25 000	25 000	25 000	25 000	25 000	25 000	25 000
Shpenzime udhëtimi të brendshëm			8 000	48 000	48 000	42 000	
Shpenzime shëndetësore							33 533
Shpenzime çerdhe/kopësht fëmijët							18 080
Mundësia për Kursime	840 225	-3 569	30 950	713 636	451 501	685 432	1 050 398

Për vitin 2008, shpenzimet e jetesës janë marrë të barabarta me pagën e bashkëshortes, sikurse është deklaruar në DPV/2008¹⁴.

Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e bonove të thesarit.

28.4.4 Në shumat e mësipërme, është analizuar mundësia e subjektit për të depozituar *cash* shumën 500,000 lekë në datën 2.5.2007. Bazuar në shkresën nr.*** prot., datë 14.9.2020 nga ILDKPKI¹⁵, në lidhje me deklarin e bonove të thesarit në DPV/2007 subjekti sqaron “.....kjo shumë përbëhet nga shuma 500,000 lekë e depozituar nga bashkëshortja në vitin 2005 si kursime të saj 100%, pasi ka qenë beqare, 600,000 lekë si kursime të përbashkëta nga të dy si deklarues, të deklaruara si *cash* dhe 1,000,000 lekë të krijuara në vitin 2007 nga të ardhurat nga pagat vjetore.”

28.4.5 Në DPV/2007¹⁶ subjekti deklaron shumën 1 milion lekë si “të ardhura të kursyera nga paga dhe shpërblime të krijuara gjatë vitit 2006-2007 – të ndodhura në llogarinë *** si bono thesari në Bankën e Shqipërisë”.

Megjithëse subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash*/gjendje në shtëpi në DPV/2006, ai e ka bërë këtë deklarin në DPV/2007. Nga lëvizjet e llogarive të pagave të dy bashkëshortëve në “Raiffeisen Bank”, rezulton se gjatë vitit 2006, është tërhequr nga banka shuma 1,412,500 lekë¹⁷. Ndërsa shpenzimet e përllogaritura gjatë vitit 2006 janë 487,817 lekë¹⁸, diferenca prej 924,683 lekësh është më se e mjaftueshme për krijimin e shumës 600,000 lekë kursime *cash*, sikurse deklaron subjekti para ILDKPKI-së.

28.4.6 Bazuar në (a) deklarin e mësipërme, (b) verifikimin e krijimit të shumës 1 milion lekë në vitin 2007 në “Raiffeisen Bank”¹⁹ (c) përllogaritjet mbi kursimet nga pagat e vitit 2006 të tërhequra nga llogaritë e pagave, rezulton se subjekti ka patur mundësi të krijojë shumën 500,000 lekë të depozituar në datën 2.5.2007.

28.5 Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “Tirana Bank” rezulton se në datë 19.12.2013 është transferuar shuma 33.500 euro nga z. F. H.. Kjo shumë është tërhequr nga subjekti në datën 20.12.2013.

¹⁴ Në DPV/2008 subjekti deklaron “Të ardhura nga paga e bashkëshortes si gjyqtare në Gjykatën e rrethit Korçë, të realizuara në 2008 shuma 785,664 lekë (të shpenzuara.”

¹⁵ Procesverbali datë 11.2.2015, përgjigje e pyetjes 2 ku subjekti dhe bashkëshortja janë pyetur mbi deklarin e tyre në DPV/2007 mbi bonot e thesarit në shumat 1,000,000 lekë përkatësisht për secilin nga bashkëshortët.

¹⁶ Rubrika “Ndryshimet e interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”

¹⁷ 1 janar - 31 dhjetor 2006, Banka “Raiffeisen”, tërheqjet nga llogaria e subjektit janë 586,500 lekë dhe nga llogaria e bashkëshortes 826,000 lekë.

¹⁸ Shih analizën financiare për vitin 2006, ku mundësia për kursime rezulton 840 224 lekë, që tregon se subjekti ka patur mundësi financiare për të kryer shpenzimet dhe krijuar likuiditetet respektive.

¹⁹ Shih tabelën përmbledhëse të lëvizjeve në “RZB Bank”, rreshti 4, janar - nëntor 2007, gjendje në llogari shuma 922,500 lekë, e cila është krijuar nga mostërheqjet/kursime nga pagat.

Në lidhje me shumën 33.500 euro, subjekti i rivlerësimit ka depozituar së bashku me deklaratën “Vetting” edhe deklaratë noteriale nr. ***, datë 6.1.2014, nëpërmjet së cilës z. F. H. deklaroi se me qëllim blerjen e banesës në datën 19.12.2013, i ka dhënë në formë huaje pa interes të afërmve të tij, shtetasve Qemal dhe V. Zaimi, shumën 33.500 euro e barasvlefshme me 4.700.000 lekë. Këtë shumë e ka patur të depozituar në “Tirana Bank” dhe deklaruesit Qemal dhe V. Zaimi do t’ia shlyenin këtë hua me marrjen e kredisë bankare prej tyre.

Shlyerja e huas vërtetohet me nxjerrjen e llogarisë së subjektit dhe bashkëshortes së tij në “OTP Bank” nga ku rezulton se në datën 3.3.2014²⁰ është transferuar shuma 4,664,000 lekë në llogarinë e z. F. H..

28.6 Në deklaratën “Vetting”, subjekti nuk ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit këtë hua, por ndërkohë tek seksioni “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” ai ka deklaruar:

“Hua afatshkurtër dhe pa interes e marrë nga shtetasi F. M. H. (*burri i vajzës së hallës*), me qëllim pagimin e këstit të blerjes së apartamentit në shumën 33.500 euro, (*ose 4.700.000 lekë*), në datën 19.12.2013 nga Banka “Tirana” dhe e shlyer plotësisht me marrjen e kredisë bankare në Bankën “Societe Generale Albania” sh.a. në datën 3.3.2014, e pasqyruar me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr.*** kol., datë 6.1.2014, përpiluar në Dhomën e Noterisë Tiranë.”

28.7 Komisioni ka hetuar²¹ në lidhje me aftësitë financiare të z. H., në momentin e dhënies së kësaj huaje. Nga hetimi ka rezultuar se:

- a. Është i regjistruar si person fizik me NIPT *** me objekt shërbime në ndërtim. Në lidhje me këtë aktivitet nga ana e DRT-së Tiranë informohemi se xhiro dhe fitimi i realizuar (në lekë) për periudhën deri në dhënien e huas është si më poshtë:

Viti	Qarkullimi	Fitimi pas tatimit
2011	7,233,194	4,099,612
2012	6,598,498	4,008,014
2013	0	0

Për vitin ushtrimor 2013, nga tatimpaguesi “F. H.” person fizik me NIPT ***, në situatën financiare janë deklaruar shitje në shumën 3.245.000 lekë.

Subjekti nuk ndan dividend, pasi bazuar në nenin 5.6 “Vendimi për destinimin e fitimit” të urdhrorit të ministrit të Financave nr. 5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, subjekti nuk ka detyrim të depozitojë pranë administratës tatimore vendimin e organit kompetent vendimmarrës të shoqërisë lidhur me rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe destinimin e fitimit pas tatimit, pasi është person fizik.

- b. Është i regjistruar si person fizik me NIPT *** me objekt “Bar – kafe”. Statusi çregjistruar. DRT-ja Tiranë informon se shtetasi F. M. H. i datëlindjes 8.4.1955 është i regjistruar me NIPT *** me aktivitet “Bar-kafe” me përgjegjësinë tatimore biznesi i vogël, regjistruar në QKR në datë 28.09.2011 dhe ka aplikuar për mbyllje të aktivitetit në datë 29.12.2017. Të ardhurat e deklaruara ndër vite, për këtë nipt për periudhën deri në dhënien e huas, janë si më poshtë:

²⁰ Kredia është disbursuar në datë 26.02.2014 në shumën 4,700,000 lekë.

²¹ Shkresë nr. *** datë 28.07.2020 drejtuar bankave; kthim përgjigjeje “Tirana Bank” nr. *** prot., datë 30.07.2020; kthim përgjigjeje Banka e Shqipërisë nr. *** prot., datë 31.07.2020; kthim përgjigjeje “OTP Bank” nr. prot. *** datë 4.8.2020; kthim përgjigjeje “BKT” nr. ***, datë 14.08.2020; shkresë nr. *** prot., datë 28.7.2020 drejtuar QKB-së; kthim përgjigjeje QKB-ja nr. *** prot., datë 7.8.2020; shkresë nr. *** prot., datë 18.7.2020 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; kthim përgjigjeje DRT-ja Tiranë nr. *** prot., datë 20.8.2020; shkresë nr. *** prot., datë 28.7.2020 drejtuar ASHK-së; kthim përgjigjeje Drejtoria Vendore Tiranë Veri nr. *** prot., datë 11.9.2020;

- Për vitet 2011 dhe 2012 nuk ka plotësuar pasqyrë të ardhura dhe shpenzime.
- Për vitin 2013 subjekti ka deklaruar të ardhura 0 (zero) lekë, shpenzime 0 (zero) lekë.

28.8 Sa i takon mundësisë së z. F. H. për të dhënë hua shumën 33,500 euro në datën 19.12.2013, është bërë analiza financiare për këtë shtetas, e cila është pasqyruar në tabelën më poshtë.

<i>Huadhënësi</i>	2 011	2 012	<i>deri 19.12.2013</i>	Total
Pagë (Stm PC + T.Bank)			109 770	109 770
Fitime nga PF 1	4 099 612	4 008 014	0	8 107 626
Fitime nga PF 2	0	0	0	0
Të ardhura nga shitje pasurie		615 296		615 296
Të ardhura	4 099 612	4 623 310	109 770	8 832 692
Shpenzime jetese	409 860	418 644	423 072	1 251 576
<i>Ndryshimi i likuiditeteve</i>	<i>2 097 041</i>	<i>-2 076 957</i>	<i>-20 027</i>	<i>57</i>
Likuiditete (gjendje)	2 097 041	20 084	57	
Shpenzime të tjera/hipoteke	6 053	7 800		13 853
Mundësia për kursim	1 586 658	6 273 823	-293 275	7 567 206
<i>Mundësia për kursim kumulative</i>	<i>1 586 658</i>	<i>7 860 481</i>	<i>7 567 206</i>	

Në analizën financiare është përdorur metoda kumulative derisa huadhënësi nuk është subjekt i deklarimit të pasurisë.

28.9 Në vlerësimin e aftësive huadhënëse të zotit F. H., Komisioni është përqëndruar në periudhën 2011-19.12.2013, sepse: (i) në pyetësorin standard subjekti ka deklaruar se burimi i të ardhurave të huadhënësit është aktiviteti i biznesit të huadhënësit; (ii) nga të dhënat e DRT-së Tiranë dhe QKB-së konstatohet se huadhënësi ka ushtruar aktivitete tregtar në këtë periudhë. Të ardhurat e përfshira janë fitimet e personit fizik për vitet 2011-2012 dhe pagat e tij deri në 19.12.2013²².

Shpenzimet e jetesës janë llogaritur sipas standardit të ILDKPKI-së dhe përbërjes familjare të z. H.²³.

Të dhënat për likuiditetet janë marrë nga provat shkresore të administruara nëpërmjet sistemit bankar. Gjatë periudhës 2011-2013 huadhënësi nuk ka rezultuar që të ketë blerë pasuri të paluajtshme apo të ketë shtuar likuiditete.

28.10 Komisioni vlerëson se bazuar në analizën financiare të kryer për huadhënësin rezulton se ai ka patur të ardhura të mjaftueshme në shumën 7 567 206 lekë, që mundësojnë dhënien e huas në shumën 33.500 euro, në datën 19.12.2013.

²² Shkresa "Tirana Bank" nr. *** prot. datë 16.9.2020.

²³ Sipas regjistrimit të gjendjes civile familja e z. F. H. përbëhet nga 3 persona.

28.11 Në datën 4.2.2014 me kontratë kredie bankare²⁴ afatgjatë për shtëpi, nr. ***, subjekti ka marrë kredi në shumën 4.700.000 lekë me afat 96 muaj. Në kontratën e kredisë në nenin B/2 është përcaktuar se kredia do të kalojë me transfertë në llogarinë e z. F. H. për likuidim detyrimi. Bazuar në deklaratën noteriale nr. ***, datë 6.2.2020 vërtetohet se subjekti ka shlyer plotësisht kredinë ndaj “OTP Bank”.

28.12 Nga hetimi i Komisionit në lidhje me figurën e huadhënësit, nuk kanë rezultuar të dhëna që mund të ndikojnë në figurën e subjektit, me cilësinë e huamarrësit.

28.13 Në përfundim të hetimit dhe analizës për këtë pasuri, Komisioni vlerëson se të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes së tij kanë qenë të mjaftueshme për krijimin e likuiditeteve të përdorura si burim për blerjen e apartamentit. Huadhënësi ka patur burime të ligjshme për dhënien e huas. Megjithëse subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën “Vetting” këtë hua si burim i mirëfilltë për pasurinë, rezulton se ai e ka deklaruar atë në rubrikën e detyrimeve në këtë deklaratë. Komisioni konkludon se: (i) subjekti ka deklaruar saktë pasurinë; (ii) subjekti ka patur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme si burim për blerjen e kësaj pasurie.

29. Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” **gjendje**²⁵ në llogarinë rrjedhëse të subjektit Qemal Zaimi pranë “Raiffeisen Bank”, e ardhur nga paga si inspektor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë në datën 24.1.2017. Vlera 103.198,92 lekë. Zotëron 50%.

Hetimi dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni²⁶

29.1 Nga nxjerrja e llogarisë së subjektit në “Raiffeisen Bank” rezulton se në datën 10.12.2019, ai ka transferuar shumën 1,400,378 lekë për të shlyer kredinë, konfirmuar dhe nga gjendja e llogarisë dyemërore të subjektit dhe bashkëshortes së tij në “OTP Bank”. Gjendja e llogarisë në datën 6.1.2017 ka qenë 103,198.92 lekë. Të ardhurat në këtë llogari e kanë burimin nga paga e subjektit. Komisioni konkludon se subjekti ka qenë i saktë në deklaram.

30. Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” **gjendje**²⁷ në llogarinë rrjedhëse të bashkëshortes V. Z. pranë “Credins Bank” e ardhur nga paga si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 24.1.2017. Vlera 35.067,42 lekë. Zotëron 50%.

Hetimi dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni²⁸

30.1 Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortes së subjektit në “Credins Bank” rezulton se gjendja e llogarisë në datë 24.01.2017 ka qenë 35,067 lekë. Kjo është llogari page e bashkëshortes.

Komisioni në përfundim konstaton nuk ka dyshime për këtë pasuri. Subjekti ka qenë i saktë në deklaram.

²⁴ Shlyerja e kredisë është siguruar me kontratë hipotekimi nr. ***, datë 24.2.2014 nëpërmjet së cilës është vënë në hipotekë apartamenti në pronësi të subjektit.

²⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: “Raiffeisen Bank” (nxjerrje llogarie) për llogarinë në emër të shtetasit Qemal Zaimi me gjendje llogarie në datën 6.1.2017 në vlerën 103.004 lekë.

²⁶ Komisioni ka marrë informacion nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 28.07.2020 drejtuar bankave.

²⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: “Credins Bank” (printim i datës 23.1.2017) të llogarisë në emër të shtetasës V. Z., me gjendje llogarie në datën 23.1.2017, në vlerën 35.067,42 lekë.

²⁸ Komisioni ka marrë informacion nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 28.7.2020 drejtuar bankave.

31. Nga hetimi ka rezultuar se në DVP/2003 bashkëshortja e subjektit ka deklaruar shtëpi banimi 2+1, me vlerë 1,500,000 lekë, nr.pasurie *** në proces privatizimi. Pjesa takuese 0%.

31.1 Bazuar në procesverbalin²⁹ e mbajtur më 11.02.2015, vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar se pjesa takuese e saj në këtë pasuri është 0% dhe se shuma 1,500,000 lekë është vlera e tregut.

31.2 Në lidhje me këtë apartament, subjekti në përgjigje të pyetësorit të parë ka sqaruar se bashkëshortja e tij, në datën kur është dorëzuar DVP/2003, ka jetuar në të njëjtin trung familjar bashkë me prindërit e saj Xh. dhe D. Ç., në qytetin e Përrenjasit, rrethi Librazhd. Në këto kushte ata konsideroheshin si persona të lidhur, prandaj bashkëshortja ka deklaruar pasurinë që figuronte në emër të prindërve të saj në atë kohë. Pasuria e vetme që prindërit e saj kanë pasur është apartamenti i banimit ku jetonin, e cila u ka kaluar në pronësi me anë të privatizimit, sipas ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Nga ana e bashkëshortes është deklaruar vlera e banesës prej 1.500.000 lekë. Kjo vlerë është vënë duke bërë një vlerësim me përafërsi të vlerës së tregut të banesave, në kohën e deklarimit, në qytetin Përrenjas, Librazhd. Pas përfundimit të përditësimit të pasurive të paluajtshme është lëshuar certifikata e pronësisë me nr. ***, datë 23.07.2001. Certifikata është lëshuar në emër të bashkëpronarëve Xh. R. Ç. dhe D. R. Ç..

31.3 Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti rezulton se pronar të këtij apartamenti janë prindërit e bashkëshortes dhe se ajo në datën 1.12.1992, ka qënë në përbërjen familjare të kryefamiljarit Xh. R. C., por 15 vjeçe. Pra, nuk ishte në moshë madhore dhe për pasojë nuk ka përfituar asnjë pjesë pronësie nga privatizimi i apartamentit të banimit.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

32. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën “Vetting”, pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

32.1 Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Qemal Zaimi, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohej parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

32.2 Siç u evidentua edhe më sipër, Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor.

32.3 Subjekti rezulton me një bilanc negativ në momentin e blerjes së automjetit të tij në qershor të vitit 2010 në shumën 236 337 lekë, shumë e cila, në vlerësim të Komisionit, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e tyre në raport

²⁹ Shih shkresën e ILDKPKI-së nr.*** prot., datë 14.9.2020.

me provat e tjera të administruara nga Komisioni nëpërmjet hetimit të tij, vlerëson se kjo mungesë të ardhurash në këtë moment nuk mund të shërbejë si shkak për masë disiplinore, duke qenë se nuk përmbushen kriteret e parashikuara në pikën 1 dhe 3 të nenit 61.

32.4 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Qemal Zaimi, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

33. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (referuar si “DSIK”), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Qemal Zaimi, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka patur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit 84/2016.

33.1 Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39, të ligjit 84/2016, ka dërguar në Komisionin e Pavaruar të Kualifikimit raportin³⁰ mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Qemal Zaimi, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës si dhe; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

33.2 Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

33.3 Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, z. Qemal Zaimi, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara rishtazi nga agjensitë ligjzbatuese apo fakteve të dala gjatë hetimit.

🚦 Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

34. Duke e konsideruar procesin e rivlerësimit një proces kushtetues që, megjithëse përfshin edhe kufizimin e të drejtave të subjekteve të rivlerësimit, kërkohet që ai gjithnjë duhet të kryhet në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, raporti për subjektin e rivlerësimit duhet të jetë konkret, sa më i qartë, mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, lidhje këto që mund ta bëjnë edhe subjektin e rivlerësimit lehtësisht të ndikueshëm prej tij.

35. Nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë ai është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

36. Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës,

³⁰ Raporti me nr. *** prot., datë 26.10.2017, deklasifikuar plotësisht me Vendim të KDZH nr. ***, datë 1.12.2020.

si dhe nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar në kuptim të pikës 15 të nenit 3 të ligjit 84/2016, duke konkluduar se, subjekti i rivlerësimit, z. Qemal Zaimi ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- (i) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ; Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të të vlerësimit të parashikuara në vendimin nr. ***, datë 29.04.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të kryeinspektorit dhe inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”³¹;
- (ii) denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

I. GJETJET NGA FORMULARI I VETËDEKLARIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA VETË SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

Formulari është plotësuar sipas formës standarde, në mënyrë të plotë, i nënshkruar rregullisht, pa mangësi nga pikëpamja formale. Subjekti ka deklaruar si periudhë të rivlerësimit 3 vite kalendarike 2014, 2015, 2016.

b) Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit

Sipas të dhënave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në rubrikën “B” të formularit, për periudhën 1 tetor 2001 - 31 gusht 2007, subjekti ka deklaruar se ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Librazhd dhe është larguar për shkak të suprimimit të asaj gjykate. Në periudhën 1.9.2007 - 16.12.2007, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe është larguar për shkak emërimi në detyrën e inspektorit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Në periudhën 17.12.2007, deri në datën e dorëzimit të formularit të vetëvlerësimit (datë 26.01.2017), ka ushtruar detyrën e inspektorit pranë Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Aktualisht, subjekti i rivlerësimit, ushtron detyrën e nëpunësit përgjegjës në njësinë e vlerësimit etik e profesional të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

c) Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit se gjatë tre viteve të fundit ka ushtruar detyrën e inspektorit në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në seksionin e inspektimit dhe të verifikimit të ankesave.

d) Trajnimet në 3 vitet e fundit në Shkollën e Magjistraturës

Sipas dokumentacionit të paraqitur, subjekti i rivlerësimit në periudhën 8.10.2013 - 8.10.2016, ka qënë pjesëmarrës në 2 aktivitete trajnuese të kësaj shkolle.

³¹ Shih nenin 42/3 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

*Deklarimet e mësipërme janë të dokumentuara nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës, me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2016.*

Subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë pjesëmarrës jashtë periudhës së rivlerësimit, në 5 aktivitetete të tjera trajnuese të Shkollës, jashtë periudhës së rivlerësimit me temat përkatëse. Këto trajnime shoqërohen me çertifikatat e trajnimit, të lëshuara nga Shkolla e Magjistraturës. Lidhur me trajnimet e tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, subjekti ka deklaruar pjesëmarrje në 3 trajnime, të zhvilluara brenda periudhës së rivlerësimit 8.10.2013 - 8.10.2016. Këto deklarime janë të mbështetura në kopje të certifikatave përkatëse të lëshuara nga organizuesit e aktiviteteve, dokumente këto bashëklidhur formularit të rivlerësimit të dorëzuar nga subjekti.

e) Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur 3 dokumente ligjore, të cilët analizohen në vijim:

1. Relacion datë 6.10.2014 “Mbi verifikimin e informacionit të paraqitur nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, A. B., me shkresën nr. *** prot., datë 13.5.2014, që lidhet me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarëve M. Q., A. M. dhe B. Sh., gjithsej 11 fletë.

Relacioni është i organizuar në 5 pjesë: i) përmbajtja e ankesës ii) rrethanat e çështjes iii) analiza e çështjes iv) informacione të tjera v) konkluzione. Raporti është nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit si inspektor i parë i ngarkuar në hartimin e aktit, si dhe inspektori tjetër M.P.

Fillimisht, në relacion paraqiten të dhëna të përgjithshme mbi urdhrin e verifikimit të nxjerrë për zbatim, identifikohet shkelja disiplinore objekt verifikimi, si dhe subjektet ndaj të cilëve ka filluar verifikimi. Identifikohet baza ligjore e aplikueshme për kryerjen e verifikimit dhe raportimi përkatës.

Në pjesën “*përmbajtja e ankesës*”, identifikohet subjekti ankues dhe përmbajtja e ankesës, në të cilën paraqiten të dhënat thelbësore të verifikueshme, identifikohet çështja gjyqësore dhe natyra e pretendimeve të ankuesit si dhe provat të cilat shoqërojnë ankesën.

Në pjesën “*rrethanat e çështjes*”, paraqiten faktet e rrethanat e rezultuara nga verifikimi i kryer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarëve që kanë shqyrtuar çështjen gjyqësore.

Në pjesën “*analiza e çështjes*”, fillimisht parashtrohet shkelja ligjore e pretenduar nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Korçë, ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarëve objekt inspektimi në çështjen penale të gjykuar prej këtyre të fundit. Identifikohet se cilat veprime apo mosveprime të gjyqtarëve objekt inspektimi, përbëjnë shkelje ligjore, duke individualizuar sjelljen e secilit gjyqtar anëtar i trupit gjykues në raport me ligjin, natyra e shkeljes që përbën shkak për procedim disiplinor, si dhe tregohet dispozita ligjore që parashikon llojin e shkeljes së disiplinës të konsumuar nga gjyqtari përkatës.

Në pjesën “*informacione të tjera*”, paraqiten të dhëna të përgjithshme mbi performancën e gjyqtarit subjekt verifikimi dhe të dhëna nga dosja e tij personale.

Ndërsa në pjesën e fundit të quajtur “*konkluzioni*”, paraqitet propozimi përkatës drejtuar organit kompetent Ministrisë së Drejtësisë për t’u vlerësuar mundësia e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit.

Relacioni i është nënshtruar kontrollit hierarkik në Inspektorat dhe është miratuar pa ndryshime nga zëvendëskryetari i KLD-së.

Paragrafët janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt, janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive, mënyra e organizimit të raportit e bën lehtësisht të kuptueshëm shkeljen disiplinore të konstatuar.

2. Relacion datë 31.7.2015 “Për verifikimin e informacionit të paraqitur nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë S. H., me shkresën nr. *** prot., datë 13.07.2015”, që lidhet me veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarit A. B., gjithsej 19 fletë.

Relacioni është i organizuar në 5 pjesë: i) përmbajtja e ankesës ii) rrethanat e çështjes iii) analiza e çështjes iv) informacione të tjera v) konkluzione. Raporti është nënshtruar nga subjekti i rivlerësimit si inspektor i parë i ngarkuar në hartimin e aktit, si dhe inspektori tjetër N.GJ.

Fillimisht, në relacion paraqiten të dhëna të përgjithshme mbi urdhrin e verifikimit të nxjerrë për zbatim, identifikohet shkelja disiplinore objekt verifikimi si dhe subjekti ndaj të cilit ka filluar verifikimi. Identifikohet baza ligjore e aplikueshme për kryerjen e verifikimit dhe raportimi përkatës.

Në pjesën “*përmbajtja e ankesës*”, identifikohet subjekti ankues dhe përmbajtja e ankesës, në të cilën paraqiten të dhënat thelbësore të verifikueshme, identifikohet çështja gjyqësore dhe natyra e pretendimeve të ankuesit si dhe provat të cilat shoqërojnë ankesën.

Në pjesën “*rrethanat e çështjes*”, paraqiten faktet e rrethanat e grumbulluara nga verifikimi i kryer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit A. B., në lidhje me gjykimin e një çështje penale të gjykuar prej tij dhe për të cilën është paraqitur ankesë nga kryetari i asaj gjykate. Pasqyrohet ecuria e gjyqimit të çështjes së inspektuar, si dhe parashtrihen shpjegimet e dhëna nga gjyqtari objekt inspektimi rreth ankesës, por edhe aktorë të tjerë pjesë e procesit, si kryetari i gjykatës, kancelarja e gjykatës, prokurori i çështjes, si dhe sekretarja gjyqësore që asistoi gjyqtarin A.B. gjatë atij gjykimi.

Në pjesën “*analiza e çështjes*”, fillimisht risillen në vëmendje faktet e rezultura nga inspektimi, duke përfshirë gjithë veprimet procedurale të kryera nga gjyqtari A.B..

Më tej, analizohen nga pikëpamja e ligjit veprimet e kryera nga gjyqtari, duke marrë në analizë edhe shpjegimet e dhëna prej tij gjatë inspektimit, por edhe shpjegimet e aktorëve të tjerë të marra gjatë inspektimit. Në fund të pjesës “*analiza e çështjes*”, argumentohet se veprimi i gjyqtarit për të ndërhyrë në përmbajtje dhe në dispozitiv të vendimit pasi e ka dhënë atë, nuk përfaqëson “një ndreqje të gabimit material”, sikurse pretendon gjyqtari, por përbën një ndryshim të vendimit të dhënë, veprim të cilin gjyqtari e ka të ndaluar ta kryejë, pasi një veprim i tillë mund të kryhet vetëm nga gjykatat më të larta mbi bazën e ankimit.

Nënndarja “*informacione të tjera*”, paraqiten të dhëna të përgjithshme mbi performancën e gjyqtarit.

Nënndarja “*konkluzioni*”, paraqitet propozimi përkatës drejtuar organit kompetent Ministrisë së Drejtësisë për t’u vlerësuar mundësia e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit për shkeljen e konstatuar.

Relacioni i është nënshuar kontrollit hierarkik në Inspektorat dhe është miratuar pa ndryshime nga kryetari i KLD-së.

Paragrafët janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt, janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive, mënyra e organizimit të raportit e bën lehtësisht të kuptueshëm shkeljen disiplinore të konstatuar.

3. Raport “Mbi inspektimin e përbashkët KLD-MD, të ankesës publike ndaj gjyqtarëve G. B. e B. Ç. të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për shkelje të rregullave të etikës dhe kryerjen e veprimeve që diskretitojnë rëndë figurën e gjyqtarit.”

Relacioni është i organizuar në 4 pjesë: i) përmbledhje ekzekutive ii) faktet e konstatuara, iii) analiza e çështjes iv) konkluzione. Raporti është nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit si inspektor i parë i ngarkuar në hartimin e aktit nga inspektorët e Ministrisë së Drejtësisë, nga kryeinspektorja e KLD-së, si dhe nga drejtuesja e Drejtorisë së Inspektimit Gjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë.

Në pjesën “*përmbledhje ekzekutive*”, relatohet se KLD-ja ka urdhëruar kryerjen e një inspektimi të përbashkët nga të dy inspektoratet. Sqarohet objekti i inspektimit, shkeljet e gjyqtarëve objekt inspektimi të pretenduara në ankesën publike, çështja civile objekt inspektimi, inspektorët e ngarkuar me inspektimin dhe fazat në të cilat do të realizohet ky proces deri në hartimin e raportit të inspektimit.

Në pjesën “*faktet e konstatuara*”, fillimisht sillen në vëmendje “ankesa e bërë publike në një emisionin televiziv investigativ”, ku ngrihen pretendime për veprime e sjellje që diskretitojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit për dy gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, G.B., njëherazi kryetar i gjykatës dhe për B.Ç., gjyqtare në atë gjykatë. Më tej, prezantohen të dhënat e konstatuara, nga verifikimi i kryer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë nga grupi i inspektimit. Në pjesën “*analiza ligjore*”, parashtrohen të dhënat e konstatuara gjatë inspektimit dhe analiza ligjore e tyre në lidhje me veprimtarinë gjyqësore dhe etike të gjyqtarit G.B.

Tek pjesa e titulluar “*konkluzioni*”, paraqitet propozimi përkatës drejtuar organit kompetent Ministrisë së Drejtësisë për t’u vlerësuar mundësia e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarës B.Ç., për shkeljet e disiplinës të konstatuara në raport.

Ndërkohë, është propozuar mbajtja në verifikim në vijim e ankesës për gjyqtarin G.B., deri në zbardhjen e plotë nga organi procedues të audio-përgjimit të pasqyruar në media.

Relacioni i është nënshuar kontrollit hierarkik dhe është miratuar pa ndryshime nga drejtuesit e të dy inspektorateve KLD-MD.

Paragrafët janë të strukturuar në mënyrë të qartë dhe të rregullt, janë respektuar rregullat drejtshkrimore në ndërtimin e fjalive, mënyra e organizimit të raportit e bën lehtësisht të kuptueshëm shkeljen disiplinore të konstatuar.

f) Dokumente të tjera të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit
Subjekti i rivlerësimit në pikën 6 të rubrikës “C” të formularit, ka paraqitur të dhëna të tjera lidhur me vlerësimet profesionale të kryera ndaj tij në periudhën e rivlerësimit, të cilat paraqiten si më poshtë vijon:

1. Vendimi i KLD-së nr. ***, datë 2.10.2015, mbi vlerësimin përfundimtar “shumë mirë” të gjyqtarit Qemal Zaimi për periudhën 01.01.2005 - 31.12.2006, sipas tabelës “vlerësimi përfundimtar”, bashkëlidhur.
2. Vendimi i KLD-së nr. ***, datë 20.6.2016, mbi vlerësimin përfundimtar “shumë mirë” të inspektorit Qemal Zaimi për periudhën kohore 2013 - 2014, sipas tabelës “vlerësimi përfundimtar”, bashkëlidhur.

Deklarimet e mësipërme janë të dokumentuara nga ana e subjektit.

II. PËRSHKRIMI I 5 DOKUMENTEVE LIGJORË TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

1. Relacioni i shqyrtimit paraprak mbi verifikimin e ankesës së paraqitur në KLD nga shtetasi S. F., me nr. *** prot., datë 20.4.2015, për mosrespektim formal të ligjit dhe zvarritje gjyqimi ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, pa cituar emrat e tyre.

Konstatohet se subjekti, është caktuar për vlerësimin paraprak të ankesës së shtetasit S.F, në datën 20.4.2015. Objekti i ankesës ka qënë veprimtaria e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Nga përmbajtja e ankesës nuk përcaktohen emrat e gjyqtarëve ndaj të cilëve adresohen pretendime për shkelje të ligjit.

Nga vëzhgimi i relacionit paraprak rezultoi si vijon:

Relacioni është i organizuar në 4 pjesë: i) përmbajtja e ankesës ii) analiza e çështjes iii) informacione të tjera iv) konkluzione. Raporti është nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit si inspektor i vetëm i ngarkuar me hartimin e aktit.

Relacioni paraprak është hartuar sipas modelit standard, duke përshkruar përmbajtjen e ankesës, analizën e çështjes, informacion mbi ankesat e tjera eventuale dhe konkluzionet. Tek analiza ligjore jepet një lidhje e saktë midis fakteve të konstatuara dhe ligjit të zbatueshëm, duke konkluduar mbi pretendimet e ngritura në ankesë. Gjuha e përdorur është profesionale, e saktë, me metodologji të qartë dhe në përputhje me rregullat e drejtshkrimit.

Raporti i shqyrtimit paraprak është përfunduar në datën 12.5.2015, brenda afatit 30-ditor të parashikuar në nenin 5 pika 4 të vendimit të KLD-së nr. ***, datë 29.4.2015 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të kryeinspektorit dhe inspektorëve të KLD-së”.

Relacioni i është nënshkruar kontrollit hierarkik dhe është miratuar pa ndryshime nga drejtuesit e Inspektoratit të KLD-së.

Në praktikën dokumentare të vënë në dispozicion nga administrata e KLGJ-së rezulton se ajo është e plotë, duke filluar prej ankesës me shkrim të subjektit ankues të protokolluar në KLD, shënimin e kryeinspektorit për kalimin për trajtim të ankesës subjektit, relacionin e hartuar nga inspektori pas shqyrtimit paraprak të ankesës, si dhe kthimi i përgjigjes me shkrim ankuesit mbi rezultatet e trajtimit të ankesës.

2. Relacion i shqyrtimit paraprak, mbi verifikimin e ankesës së paraqitur në KLD nga shtetasi R. D., me nr. *** prot., datë 16.1.2014, për mosrespektim formal të ligjit dhe zvarritje gjykimi ndaj gjyqtarit P. V. të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

Konstatohet se subjekti është caktuar për vlerësimin paraprak të ankesës së shtetasit R.D, në datën 16.1.2014. Objekti i ankesës ka qënë veprimtaria e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë P. V..

Nga vëzhgimi i relacionit paraprak rezultoi si vijon:

Relacioni është i organizuar në 4 pjesë: i) përmbajtja e ankesës ii) analiza e çështjes iii) informacione të tjera iv) konkluzione. Raporti është nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit si inspektor i vetëm i ngarkuar me hartimin e aktit.

Relacioni paraprak është hartuar sipas modelit standard, duke përshkruar përmbajtjen e ankesës, analizën e çështjes, informacion mbi ankesat e tjera eventuale dhe konkluzionet. Tek analiza ligjore jepet një lidhje e saktë midis fakteve të konstatuara dhe ligjit të zbatueshëm, duke konkluduar mbi pretendimet e ngritura në ankesë. Gjuha e përdorur është profesionale, e saktë, me metodologji të qartë dhe në përputhje me rregullat e drejtshkrimit.

Raporti i shqyrtimit paraprak është përfunduar në datën 12.2.2014, brenda afatit 30-ditor të parashikuar në nenin 5 pika 4 të vendimit të KLD-së nr. 36, datë 29.4.2015 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të kryeinspektorit dhe inspektorëve të KLD-së”.

Relacioni i është nënshkruar kontrollit hierarkik dhe është miratuar pa ndryshime nga drejtuesit e Inspektoratit të KLD-së.

Në praktikën dokumentare të vënë në dispozicion nga administrata e KLGJ-së rezulton se ajo është e plotë, duke filluar prej ankesës me shkrim të subjektit ankues të protokolluar në KLD, shënimin e kryeinspektorit për kalimin për trajtim të ankesës subjektit, relacionin e hartuar nga inspektori pas shqyrtimit paraprak të ankesës, si dhe kthimi i përgjigjes me shkrim ankuesit mbi rezultatet e trajtimit të ankesës.

3. Relacion përfundimtar mbi verifikimin e ankesës së paraqitur në KLD nga shtetasi K. B., me nr. *** prot., datë 27.12.2015, për zvarritje gjykimi ndaj gjyqtarëve B. T. e A. F. të Gjykatës së Apelit Durrës, si dhe ndaj gjyqtarit Y. M. të Apelit Gjyqësor Gjirokastrë, gjatë gjykimit prej tyre të një çështje civile për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë.

Konstatohet se subjekti, është caktuar për verifikimin e ankesës së shtetasit K.B., fillimisht me urdhërin e kryeinspektorit me nr. *** prot., të datës 6.2.2014 dhe më pas me urdhërin në vijim me nr. ***, datë 25.02.2014. Objekti i ankesës ka qënë veprimtaria e gjyqtarëve të Gjykatës Gjykatës së Apelit Durrës, si dhe ndaj gjyqtarit Y. M. të Apelit Gjyqësor Gjirokastrë, gjatë gjykimit prej tyre të një çështje civile për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë. Në përmbajtje të urdhërit të kryeinspektorit rezultoi se për verifikimin e ankesës janë ngarkuar dy inspektorë subjekti dhe S. Zh., ndërsa raporti i verifikimit është hartuar nga subjekti i rivlerësimit.

Nga vëzhgimi i relacionit përfundimtar rezultoi si vijon:

Relacioni është i organizuar në 5 pjesë: i) përmbajtja e ankesës ii) rrethanat e çështjes iii) analiza e çështjes iv) informacione të tjera v) konkluzioni. Raporti është nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe inspektore S.Zh.

Relacioni përfundimtar është hartuar sipas modelit standard, duke përshtetur përmbajtjen e ankesës, rrethanat e çështjes, analizën e çështjes, informacion mbi ankesat e tjera eventuale dhe konkluzionet. Tek analiza ligjore jepet një lidhje e saktë midis fakteve të konstatuara dhe ligjit të zbatueshëm, duke konkluduar mbi pretendimet e ngritura në ankesë. Gjuha e përdorur është profesionale, e saktë, me metodologji të qartë dhe në përputhje me rregullat e drejtshkrimit.

Në praktikën dokumentare të vënë në dispozicion nga administrata e KLGJ-së rezulton se ajo është e plotë, duke filluar prej ankesës me shkrim të subjektit ankues të protokolluar në KLD, urdhrin e kryeinspektorit për verifikimin e ankesës dhe inspektorët e caktuar për verifikimin, aktin e njoftimit të ankesës kryetarit të gjykatës dhe gjyqtarëve përkatës, relacionin e hartuar nga subjekti i rivlerësimit dhe inspektori tjetër i ngarkuar në urdhër, kthimi i përgjigjes me shkrim ankuesit mbi rezultatet e verifikimit të ankesës.

4. Relacion përfundimtar mbi verifikimin e ankesës së paraqitur në KLD nga shtetasi Z. I., me nr. *** prot., datë 5.6.2015, për shkelje formale të ligjit si dhe zvarritje gjykimi, ndaj gjyqtarit H. S. të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, gjatë gjykimit prej tij të një çështje civile me palë ndërgjyqëse ankuesin.

Konstatohet se subjekti është caktuar për verifikimin e ankesës së shtetasit Z.I., me urdhrin e kryeinspektorit me nr. *** prot., të datës 16.7.2015. Objekti i ankesës ka qënë veprimtaria e gjyqtarit H. S. të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në përmbajtje të urdhrin të kryeinspektorit rezultoi, se për verifikimin e ankesës janë ngarkuar dy inspektorë Qemal Zaimi dhe N. Gj., ndërsa raporti i verifikimit është hartuar nga subjekti i rivlerësimit.

Nga vëzhgimi i relacionit përfundimtar rezultoi si vijon:

Relacioni është i organizuar në 5 pjesë: i) përmbajtja e ankesës ii) rrethanat e çështjes iii) analiza e çështjes iv) informacione të tjera v) konkluzioni. Raporti është nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe inspektori tjetër N.Gj.

Relacioni përfundimtar është hartuar sipas modelit standard, duke përshtetur përmbajtjen e ankesës, rrethanat e çështjes, analizën e çështjes, informacion mbi ankesat e tjera eventuale dhe konkluzionet. Tek analiza ligjore jepet një lidhje e saktë midis fakteve të konstatuara dhe ligjit të zbatueshëm, duke konkluduar mbi pretendimet e ngritura në ankesë. Gjuha e përdorur është profesionale, e saktë, me metodologji të qartë dhe në përputhje me rregullat e drejtshkrimit.

Rezultoi se raporti është hartuar nga subjekti, 15 ditë tej afatit 30-ditor të parashikuar në nenin 5 pika 4 të vendimit të KLD-së nr. ***, datë 29.04.2015 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të kryeinspektorit dhe inspektorëve të KLD-së”.

Relacioni është nënshkruar nga të dy inspektorët e ngarkuar në urdhrin e verifikimit, i është nënshtuar kontrollit hierarkik dhe është miratuar pa ndryshime nga drejtuesit e Inspektoratit të KLD-së.

Në praktikën dokumentare të vënë në dispozicion nga administrata e KLGJ-së rezulton se ajo është e plotë, duke filluar prej ankesës me shkrim të subjektit ankues të protokolluar në KLD, urdhrin e kryeinspektorit për verifikimin e ankesës dhe inspektorët e caktuar për verifikimin, aktin e njoftimit të ankesës kryetarit të gjykatës dhe gjyqtarëve përkatës, relacionin e hartuar nga subjekti i rivlerësimit dhe inspektori tjetër i ngarkuar në urdhër, kthimi i përgjigjes me shkrim ankuesit mbi rezultatet e verifikimit të ankesës.

5. Relacion përfundimtar, mbi verifikimin e informacionit të paraqitur në KLD nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 2.7.2014, që lidhet me cenimin e disa vendimeve gjyqësore të dhëna nga disa gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe disa gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Konstatohet se subjekti është caktuar për verifikimin e informacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë si më sipër, me urdhrin e kryeinspektorit me nr. *** prot., të datës 14.10.2014. Objekti i verifikimit ka qënë veprimtaria e disa gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe veprimtaria gjyqësore e disa gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë, për vendime të dhëna prej tyre e të prishura nga gjykatat më të larta. Në përmbajtje të urdhrit të kryeinspektorit rezultoi, se për verifikimin e ankesës janë ngarkuar dy inspektorë, subjekti dhe K. V., ndërsa raporti i verifikimit është hartuar nga subjekti i rivlerësimit.

Nga vëzhgimi i relacionit përfundimtar rezultoi si vijon:

Relacioni është i organizuar në 5 pjesë: i) përmbajtja e ankesës ii) rrethanat e çështjes iii) analiza e çështjes iv) informacione të tjera v) konkluzioni. Raporti është nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe inspektori tjetër K.V..

Relacioni përfundimtar është hartuar sipas modelit standard, duke përshkruar përmbajtjen e informacionit, rrethanat e çështjes, analizën e çështjes, informacion mbi ankesat e tjera eventuale dhe konkluzionet. Gjuha e përdorur është profesionale, e saktë, me metodologji të qartë dhe në përputhje me rregullat e drejtshkrimit.

Rezultoi se raporti është hartuar nga subjekti brenda afatit 30-ditor të parashikuar në nenin 5 pika 4 të vendimit të KLD-së nr. ***, datë 29.4.2015 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të kryeinspektorit dhe inspektorëve të KLD-së”.

Relacioni është nënshkruar nga të dy inspektorët e ngarkuar në urdhërin e verifikimit, i është nënshtuar kontrollit hierarkik dhe është miratuar pa ndryshime nga drejtuesit e Inspektoratit të KLD-së.

Në praktikën dokumentare të vënë në dispozicion nga administrata e KLGJ-së rezulton se ajo është e plotë, duke filluar prej informacionit periodik të përcjellë me shkrim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e protokolluar në KLD bashkë me vendimet gjyqësore të cenuara, urdhrin e kryeinspektorit për verifikimin e informacionit periodik, inspektorët e caktuar për verifikimin, aktin e njoftimit të urdhrit të verifikimit, kryetarit të gjykatës dhe gjyqtarëve përkatës, relacionin e hartuar nga subjekti i rivlerësimit dhe inspektori tjetër i ngarkuar në urdhër.

III. TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLGJ-SË

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trivjeçare të rivlerësimit 8 tetor 2013 - 8 tetor 2016, për subjektin, gjatë ushtrimit të detyrës si inspektor pranë Inspektoratit të KLD-së, nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për subjektin përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor.

IV. ANKESAT

Për subjektin ka patur dy ankesa për një vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan të datës 30.05.2001 ku subjekti ka qenë në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues.

Nga ana e Komisioni këto denoncime nuk janë shqyrtuar, pasi nuk përfshihet në periudhën e vlerësimit të aftësive profesionale të parashikuar nga neni 41/4 i ligjit nr. 84/2016 në të cilin parashikohet se vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim.

V. ANALIZA E GJETJEVE

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit:

(i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dokumenteve ligjore të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në KLD.

1. Aftësitë organizative: në këtë grup kriteresh vlerësohet aftësia e inspektorit për të qenë efektiv në përmbushjen e detyrave të ngarkuara në aspektet e sasisë, shpejtësisë dhe metodologjisë.

a) Sasia

Përgjatë tre viteve kalendarike 2013- 2016, subjekti i rivlerësimit, është caktuar tek seksioni i ankesave dhe inspektimit. Sipas nenit 6 pika 2 të sistemit të vlerësimit, inspektori i seksionit të ankesave, duhet të hartojë raporte për jo më pak se 150 ankesa në vit. Në vlerësimin e standardit sasior merret në konsideratë deri në masën 30% edhe volumi i detyrave të tjera të përmbushura nga inspektori.

Sipas të dhënave të tabelës statistikore, në periudhën trevjeçare (8.10.2013 - 8.10.2016), subjekti ka hartuar gjithsej 535 (pesëqind e tridhjetë e pesë) relacione (raporte), nga të cilat 117 (njëqind e shtatëmbëdhjetë) relacione të shqyrtimit paraprak të ankesave për të cilat është propozuar dhe është vendosur verifikimi i ankesës, 250 (dyqind e pesëdhjetë) relacione të verifikimit të ankesave, 6 (gjashtë) raporte të inspektimeve tematike të urdhëruara nga KLD-ja dhe 162 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy) relacione të shqyrtimit paraprak të ankesave, për të cilat është propozuar dhe është vendosur arkivimi i tyre.

Referuar parashikimit të nenit 6 pika 2 të sistemit të vlerësimit (inspektori i seksionit të ankesave, duhet të hartojë raporte për jo më pak se 150 ankesa në vit), rezultoi se subjekti ka përmbushur dhe ka tejkalluar kriterin sasior të përcaktuar në sistemin e vlerësimit.

b) **Metodologjia:** me këtë kriter vlerësohet aftësia e inspektorit për të qenë efektiv në menaxhimin e kohës dhe burimeve të tjera, duke përcaktuar saktë veprimet specifike procedurale dhe planin e punës, aftësia për të përdorur sa më mirë kohën dhe burimet në

dispozicion për përfundimin e detyrave të ngarkuara në kohën e duhur në raport me sasinë e punës, si dhe aftësia për të qënë krijues dhe për të propozuar ide të reja për përmirësimin e punës.

Nga vëzhgimi i 5 dokumenteve të përzgjedhura me short, konstatohet se subjekti ka aftësi shumë të mira metodologjike, duke qënë i qartë për llojin e detyrës që i ngarkohet. Ai e menaxhon kohën dhe burimet e tjera në dispozicion në funksion të saktësisë së veprimeve procedurale që duhen kryer. Subjekti i kushton rëndësi nxjerrjes së fakteve dhe identifikimit edhe të pretendimit të gjyqtarit të verifikuar. Në çështjet që i caktohen për trajtim ka prirjen të identifikojë thelbin e çështjes. Ka aftësinë e duhur për të grumbulluar të dhënat e nevojshme përgjatë një verifikimi dhe e analizon çështjen, duke vlerësuar pozicionin e gjyqtarit.

- c) **Shpejtësia:** me këtë kriter vlerësohet aftësia e inspektorit për të zgjidhur dhe përfunduar në afatin e duhur kohor çështjet që i janë caktuar për trajtim.

Standartet kohore të veprimtarisë së inspektorit janë përcaktuar në nenin 6 pika 4 të sistemit të vlerësimit, të cilat sipas llojit variojnë nga 48 orë deri në 30 ditë, nëse afati nuk caktohet shprehimisht në urdhrin për kryerjen e detyrës. Për efekt të standardit kohor të punës, numri i rasteve në të cilat raporti hartohet jashtë afateve nuk duhet të kalojë 40% të numrit të përgjithshëm të raporteve të hartuara nga inspektori gjatë vitit kalendarik.

Nga 5 dokumentet e vëzhguara rezulton se vetëm një prej tyre, është realizuar tej afateve standard të parashikuar në aktet nënligjore që rregullojnë këtë veprimtari. Megjithatë në pasqyrimin e këtij treguesi duhet mbajtur në konsideratë volumi shumë i madh i punës i përbulluar nga inspektori, si:

- hartimi prej subjektit të rivlerësimit të një numri të lartë të relacioneve paraprake e përfundimtare, të cilat tejkalojnë kriterin sasior të përcaktuar në sistemin e vlerësimit të inspektorëve.
- pjesëmarrja e inspektorit në përgatitjen, inspektimin dhe hartimin e 6 (gjashtë) raporteve voluminoze që ju përkasin 6 (gjashtë) inspektimeve tematikë të ngarkuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.
- numri i ulët i inspektorëve që ishin efektivë në punë, pasi në atë periudhë, Inspektorati i KLD-së ka funksionuar me mungesën e pothuajse 1/3 së inspektorëve që kishte në organikën e tij.

2. Aftësitë profesionale teknike: në këtë grup kriteresh vlerësohen aspektet teknike të procesit të punës, ku përfshihet qartësia e hartimit të raportit, aftësia për të përdorur njohuritë juridike, aftësia për të hartuar raportin sipas modeleve të caktuara dhe saktësia në hartimin e raportit. Vlerësimi i aspekteve teknike të këtij kriteri kryhet duke mbajtur në konsideratë edhe aftësinë e inspektorit për të respektuar pavarësinë e gjyqtarëve dhe për të vlerësuar mjeshtërinë e arsytimit të vendimit gjyqësor.

- a) **Qartësia e hartimit të raportit:** me këtë kriter vlerësohet aftësia e inspektorit për të shkruar thjesht, qartë dhe në mënyrë profesionale raportin gjatë detyrës së tij.

Nga vëzhgimi i tre relacioneve të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit si dhe i pesë raporteve të përzgjedhura me short, konstatohet se subjekti ka aftësitë e duhura për të hartuar qartë raportet e punës. Ai i kushton rëndësi anës formale të dokumentit, duke ndjekur format standard të raporteve sipas llojit të tyre (relacioni i shqyrtimit paraprak, raport inspektimi apo raport verifikimi). Identifikon saktë rrethanat e çështjes dhe ligjin e aplikueshëm. Në rastet e verifikimit të ankesave, i kushton rëndësi edhe pretendimeve të gjyqtarit në verifikim, duke u ndalur posaçërisht tek analiza e themeltësisë së tyre. Gjuha e përdorur në raport është profesionale, e saktë, me metodologji të qartë dhe në përputhje me rregullat e drejtshkrimit.

- b) **Aftësia për të përdorur njohuritë juridike:** me këtë kriter vlerësohet niveli i njohurive të inspektorit mbi legjislacionin dhe jurisprudencën, duke përfshirë edhe përditësimin e këtyre njohurive, të cilat i përdor në mënyrë korrekte në hartimin e raportit.

Subjekti ka nivel shumë të mirë të njohurive mbi legjislacionin dhe jurisprudencën, fakt që u konstatua nga përmbajtja e tri dokumenteve të përzgjedhura me short, por edhe nga përmbajtja e 5 dokumentave të përzgjedhura me short.

Kështu, në rastet e trajtimit paraprak të ankesave (relacionet paraprake), në çdo rast, subjekti analizon nga pikëpamja ligjore pretendimet e ankuesit dhe arsyeton nëse pretendimet e parashtruara bëjnë pjesë në objektin e punës së Inspektoratit të KLD-së. Analiza juridike është kryer në përputhje me parashikimet e nenit 16 të ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, por edhe në mbështetje të kërkesave të nenit 24 të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të KLD-së”.

Gjithashtu, po në rastin e relacioneve të trajtimit paraprak, konstatohet se subjekti respekton pavarësinë e gjyqtarit në çështjet në gjykim e sipër, në përputhje me parashikimet e nenit 30/4 të rregullores së sipërcituar (shih analizën e dokumenteve 1 dhe 2).

Në rastin e verifikimit të ankesave (relacionet e verifikimit), konstatohet se subjekti respekton pavarësinë e gjyqtarit në verifikim, pasi në çdo rast, para fillimit të verifikimit, urdhri i verifikimit i komunikohet paraprakisht gjyqtarit objekt verifikimi, duke respektuar parashikimin e bërë në nenin 30 pika 2 të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të KLD-së”.

Në rastin e verifikimit të ankesave, në çdo rast, konstatohet se subjekti analizon ligjërisht veprimtarinë e gjyqtarit ndaj të cilit është adresuar ankesa në KLD, duke përfshirë edhe pretendimet e tij ndaj ankesës, bazuar në faktet e konstatuara gjatë verifikimit, dhe arsyeton rastet kur sjellja e gjyqtarit bie ndesh me ligjin dhe përbën shkelje disiplinë.

Në rastin e konstatimit të shkeljeve të disiplinës, arsyetohet lloji i shkeljes së kryer, citohet dispozita përkatëse e ligjit e cila parashikon shkeljen e disiplinës, si dhe parashtrohet autoriteti shtetëror kompetent, i cili ka të drejtën e fillimit të procedimit disiplinor.

- c) **Aftësia për të hartuar raportin sipas modeleve të caktuara:** me këtë kriter vlerësohet aftësia e inspektorit për të hartuar raportin, duke përshkruar faktet dhe ligjin e zbatueshëm, burimin dhe analizën e provave, analizën ligjore dhe konkluzionet sipas modeleve standarde të unifikuara të inspektoratit.

Nga vëzhgimi i tri raporteve të përzgjedhura nga inspektori dhe 5 të përzgjedhura me short, konstatohet se në të gjitha rastet, subjekti ka respektuar modelet e unifikuara sipas llojit të punës. Konkretisht janë vëzhguar gjashtë raporte verifikimi dhe dy raporte të shqyrtimit paraprak të ankesave. Raportet e tij nga ana formale paraqiten në nivelin e duhur dhe të kuptueshme menjëherë për llojin e tyre, si në relacionet paraprake ashtu edhe në ato të verifikimit, në asnjë rast nuk mungon parashtrimi i fakteve të konstatuara, vlerësimi i tyre në raport me provat e shqyrtuara si dhe analiza ligjore e pretendimeve të ngritura në ankesë apo informacion të kryetarit të gjykatës, analiza ligjore e veprimtarisë së gjyqtarit të verifikuar, si dhe konkluzionet e nxjerra nga inspektimi i kryer.

d) **Saktësia në hartimin e raportit:** me këtë kriter vlerësohet aftësia e inspektorit për të shkruar raportin, pa gabime ligjore apo materiale.

Konstatohet se 8 relacionet e hartuara nga subjekti i rivlerësimit dhe të analizuara në këtë raport vlerësimi profesional, janë të sakta nga ana profesionale. Ato nuk përmbajnë gabime ligjore apo materiale dhe janë miratuar pa asnjë vërejtje nga titullarët e inspektorit. Gjuha e përdorur është profesionale, e saktë, me metodologji të qartë dhe në përputhje me rregullat e drejtshkrimit.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit: në këtë grup kriteresh përfshihen etika dhe disiplina në punë, integriteti dhe paanësia e inspektorit.

a) **Etika dhe disiplina në punë:** me këtë kriter vlerësohet inspektori lidhur me përkushtimin dhe përgjegjshmërinë në detyrë, si dhe aftësia për të përmbushur rregullisht detyrat dhe për të respektuar anën formale të detyrës.

Subjekti respekton rregullat e etikës në komunikimin me eprorët, kolegët, gjyqtarët dhe qytetarët. Ai karakterizohet nga qetësia, matura dhe vendosmëria. Ai e mbron mendimin e tij dhe jep argumenta për to. Ai vjen nga radhët e gjyqësorit dhe mbart me vete vlerat e detyrës së gjyqtarit. Ai ka kujtesë institucionale dhe e ndan atë me kolegët e tjerë në inspektorat në funksion të përmbushjes së detyrave në mënyrë uniforme.

Gjithashtu, subjekti i kushton rëndësi standarteve etike në përmbushjen e detyrave në gjykata, duke ruajtur konfidencialitetin dhe paanësinë, në funksion edhe të krijimit të figurës me autoritet të inspektorit të KLD-së. Lidhur me disiplinën në punë, inspektori respekton orarin zyrtar të punës, si dhe kupton qartë natyrën urgjente të ndonjë detyre që i caktohet. Nga ana tjetër, respekton afatet procedurale dhe administrative.

b) **Integriteti:** me këtë kriter vlerësohet qëndrimi i inspektorit ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dokumentet e vëzhguara, konstatohen aftësi të dukshme komunikuese, ndjenja e përgjegjësisë në përmbushjen e detyrës, integritet dhe aftësi në ushtrimin e detyrës. Në periudhën e vlerësimit, ndaj tij nuk është paraqitur asnjë ankesë as nga gjyqtarët dhe as nga subjektet ankuuese ndaj gjyqtarëve. Po ashtu, ndaj tij nuk ka patur asnjë rast për fillimin e procedurave disiplinore.

Nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Në tri raporte verifikimi të vëzhguara (shih tri dokumentet e përzgjedhura nga vetë subjekti), konstatohet se në përfundim të inspektimit të kryer, pas konstatimit të shkeljeve të disiplinës në veprimtarinë e gjyqtarëve konkretë, subjekti, ka propozuar nisjen e procedimit disiplinor ndaj tyre, duke treguar në këtë mënyrë integritet dhe profesionalizëm në ushtrimin e detyrës.

- c) **Paanësia:** me këtë kriter vlerësohet kujdesi i inspektorit ndaj konfliktit të interesit dhe respektimi prej tij i çështjeve të grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe çështjet e barazisë gjinore dhe të pakicave.

Subjekti, i kushton rëndësi standarteve etike në përmbushjen e detyrave në gjykata, duke ruajtur konfidencialitetin dhe paanësinë, në funksion edhe të krijimit të figurës me autoritet të inspektorit të KLD-së.

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dokumentat e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimi. Nuk rezultojnë të jenë paraqitur ankesa ndaj tij për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të paanësisë përgjatë përmbushjes së detyrës, si nga qytetarët ashtu dhe nga gjyqtarët. Në 8 dokumentet ligjore nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimi. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimi të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

4. Angazhimi profesional: në këtë grup kriteresh përfshihen aftësitë e inspektorit në aspektet e kriterëve sociale dhe të rritjes profesionale.

- a) **Kriteret sociale:** Me këtë kriter vlerësohet aftësia e inspektorit për të qënë i gatshëm dhe produktiv në punën në grup, për të drejtuar në grup kur kërkohet, si dhe për të krijuar marrëdhënie bashkëpunimi dhe një mjedis të përshtatshëm për zbatimin e detyrave.

Subjekti i rivlerësimi ka shfaqur aftësi shumë të mira për punuar në grup, si dhe për të krijuar marrëdhënie bashkëpunimi dhe mjedis të përshtatshëm për zbatimin e detyrave të ngarkuara. Kështu, nga përmbajtja e shkresës me nr. *** prot., datë 26.1.2017, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, provohet se subjekti i rivlerësimi, ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në përgatitjen e 6 (gjashtë) inspektimeve tematike të ngarkuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Gjithashtu, provohet se njëri nga dokumentet e përzgjedhur nga vetë subjekti i rivlerësimi, i përket një inspektimi të përbashkët, të kryer midis Inspektoratit të KLD-së dhe Drejtorisë së Inspektimit Gjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë, prej nga ku rezulton se subjekti ka bashkëpunuar me inspektorët e Ministrisë së Drejtësisë në kryerjen e atij inspektimi, ka qënë drejtues i grupit inspektues dhe ka qënë ai që ka përpiluar raportin e inspektimit.

- b) **Rritja profesionale:** me këtë kriter vlerësohet gadishmëria e inspektorit për të marrë pjesë në aktivitete profesionale dhe trajnuese, duke përfshirë edhe vlerat e shtuara përmes publikimit të shkrimeve me natyrë juridike dhe që kanë lidhje me detyrën.

Konstatohet se subjekti i rivlerësimi, ka treguar mjaft interes për të marrë pjesë në aktivitete trajnuese, të cilat lidhen drejtpërsëdrejti me ushtrimin e detyrës së inspektorit të seksionit të ankesave dhe inspektimit, të cilat i kanë shërbyer në ngritjen e tij të mëtejshme profesionale, por edhe në punën e tij të përditshme si inspektor i inspektimit.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

45. Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGJ-ja, denoncimeve të depozituara në Komision, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale, apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

45.1 Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe, konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

45.2 Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel shumë të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

V. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se:

- i. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe;
- iii. subjekti ka një nivel shumë të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar z. Theo Jacobs, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Qemal Zaimi.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 10.12.2020

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Genta TAFA (BUNGO)
Relatore

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku